



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2381.prot.

Gramsh, më 13.06.2022

**NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK
PËR LËVIZJEN PARALELE
NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE (Përgjegjës i Sektorit të
Buxhetit)**

**Lloji i diplomës “shkencat ekonomike” niveli minimal i diplomës “Master
Shkencor”**

Në zbatim të nenit 26 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” të Këshillit të Ministrave (i ndryshuar), Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Gramsh në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të lëvizjes paralele dhe kërkesave të veçanta të shpallura në Njoftimin për konkurrim nr.2178, datë 01.06.2022 “Shpallje për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë ose pranim nga jashtë shërbimit civil, kategoria e ulët drejtuese, Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit”, njofton se:

- Nuk ka asnjë kandidat të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të procedurës;
- Ky pozicion pune është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil.

Afatet dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve që janë të interesuar për fazën e ngritjes në detyrë në shërbimin civil, mbeten të njëjtat me ato të shpallura në njoftimin nr.2178, datë 01.06.2022, të publikuara në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqa zyrtare e bashkisë www.bashkiagramsh.gov.al dhe stenda e informimit të publikut Bashkia Gramsh.

KRYETARI
Klodian TACE

